

Studimi i ri tregon se Patentat e Unionit Evropian pritet të rrisin tregtinë dhe investimet në BE.

14 nëntor 2017

Një studim i publikuar, më 14 nëntor 2017, nga EPO zbulon se Patentat u Unionit Evropian mund të rrisin ndjeshëm transferimin e teknologjisë në BE nëpërmjet investimeve më të mëdha tregtare. Harmonizimi i përmirësuar i sistemit të patentave në Evropë ka potencial për të rritur tregtinë dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) në sektorët e teknologjisë së lartë deri në 2% dhe 15% në BE, duke çuar fitimet vjetore në 14.6 miliardë euro në tregti dhe 1.8 miliardë euro në IHD. Studimi, Patentat, Tregtia dhe IHD-të në Bashkimin Evropian, i realizuar nga një ekip ekonomistësh nga EPO, Universiteti i Kolorados Boulder dhe Shkolla e Ekonomisë në Londër, tregon se, ndërsa patentat tashmë kanë një efekt pozitiv në tregtinë dhe IHD në Evropë, ndikimi i tyre aktualisht është i penguar nga mungesa e mbrojtjes së patentave në të gjithë BE-në pa pengesa. "Ky studim siguron dëshmi të mëtejshme të përfitimeve nga mbrojtja e patentave për ekonominë evropiane", tha presidenti i EPO Benoît Battistelli, "Ai përcakton në veçanti përfitimet e drejtpërdrejta të harmonizimit më të madh të sistemit për rajonin tonë". Sipas z. Battistelli, "Gjykata e Patentave të Unionit Evropian dhe Patentat e Unifikuara, të cilat pritet të zbatohen së shpejti, do të jenë një hap jetik drejt realizimit të një tregu të vetëm të BE për teknologjinë dhe do të mbështesë rritjen e produktivitetit dhe zhvillimin ekonomik në Evropë". Potencial i pashfrytëzuar në tregun e teknologjisë së Evropës Studimi fokusohet në industritë prodhuese të teknologjisë së lartë, duke përfshirë TIK, në fushën e kimikateve dhe pajisje mjekësore, të cilat përdorin intensivisht të drejtat e pronësisë intelektuale (PI). Krahasuar me industritë e tjera, këta sektorë "të mbrojtjes së lartë të PI" janë konstatuar se janë kontribues madhorë ndaj eksporteve të BE dhe flukseve të IHD-ve në pjesën tjetër të botës, duke konfirmuar rezultatet e një studimi të mëparshëm nga EPO dhe Zyra e BE-së për Pronësi Intelektuale. Në të kundërt, studimi i ri tregon se kontributi i këtyre industrive në tregtinë dhe flukset e IHD-ve midis vendeve të BE është ende i kufizuar, duke sugjeruar potencial të pashfrytëzuar për të arritur një treg të vetëm të BE-së për teknologjinë. Matja e përfitimeve ekonomike nga harmonizimi i patentave Studimi më tej zbulon se tregtia dhe flukset e IHD-ve në industritë prodhuese të teknologjisë së lartë janë veçanërisht të ndjeshme ndaj nivelit të mbrojtjes së patentave në një vend. Mbrojtja më e fortë e patentave ka një ndikim të rëndësishëm pozitiv në importet PI të lartë dhe në vlerën dhe numrin e marrëveshjeve të IHD-ve në sektorë që kanë mbrojtje të lartë PI.

Në këtë sfond, studimi identifikon disa kufizime për qarkullimin e shpikjeve të patentuara të cilat pengojnë tregtinë dhe investimet në industritë e teknologjisë së lartë brenda BE-së. Harmonizimi më i madh i mbrojtjes së patentave në BE do të nxisë tregtinë evropiane dhe IHD-të në industritë me mbrojtje të lartë të PI, përfundon analiza. Një skenar i plotë harmonizimi do të rriste tregtinë e lartë të PI dhe flukset e IHD-ve në mes vendeve të BE me 2% dhe 15% duke çuar në fitime vjetore prej 14.6 miliardë euro në tregti dhe 1.8 miliardë euro në IHD.